



## INFORMACIONE NË LIDHJE ME ZGJEDHJET LOKALE 2021

Në përputhje me kushtetutën e saj, Finlanda ndahet në komuna të vetëqeverisura. Çdo komunë është përgjegjëse për shumë nga vendimet që kanë lidhje me banorët e saj.

Organi më i lartë vendimmarrës i komunës është këshilli i komunës, i cili zgjidhet nga banorët e saj. Anëtarët e këshillit, ose këshilltarët, zgjidhen në zgjedhjet lokale për një mandat katërvjeçar. Zgjedhjet e ardhshme lokale do të mbahen ditën **e diel, më 13 qershor 2021**.

Në zgjedhjet lokale mund të votojnë dhe të kandidojnë shtetasit e Finlandës dhe, në kushte specifike, shtetasit e shteteve të tjera.

Votimi në Finlandë është në bazë vullnetare.

Në rajonin Åland, zgjedhjet lokale nuk do të zhvillohen në vitin 2021.

### E drejta e votës - kush mund të votojë

Mund të votosh në zgjedhjet lokale nëse je shtetas i Finlandës, i një shteti tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, shtetas i Islandës ose i Norvegjisë dhe plotëson kushtet e mëposhtme:

- mbush 18 vjet para ditës së zgjedhjeve (13 qershor 2021)
- je banor rezident i Finlandës para datës 23 prill 2021

Nëse je shtetas i ndonjë shteti tjetër, ti mund të votosh në zgjedhjet lokale nëse:

- mbush 18 vjet para ditës së zgjedhjeve (13 qershor 2021)
- ke qenë banor rezident i Finlandës në mënyrë të vazhdueshme për të paktën dy vite para datës 23 prill 2021.

Statusi i banorit rezident përcaktohet në bazë të ligjit për komunën e rezidencës. Në parim, komuna e rezidencës është komuna ku ti banon.

Në zgjedhjet lokale të vitit 2021, komuna e rezidencës do të përcaktohet në bazë të komunës që është regjistruar si komuna jote e rezidencës në sistemin e informacionit të popullsisë deri në 23 prill 2021 në orën 24:00.

Nëse është e nevojshme, mund ta kontrollosh komunën tënde të rezidencës nga Agjencia e Shërbimeve Dixhitale dhe të të Dhënave të Popullsisë.

Në zgjedhjet lokale, mund të votosh vetëm për një kandidat që konkurren në zgjedhjet në komunën tënde të rezidencës.

## **Një njoftim për të drejtën e votës u dërgohet të gjithë personave që kanë të drejtën për të votuar**

Agjencia e Shërbimeve Dixhitale dhe të të Dhënave të Popullsisë mban një regjistër votimi ku përfshihen informacionet për të gjithë personat që kanë të drejtën e votës. Nuk ka nevojë të regjistrohesh më vete për regjistrin e votimit.

Agjencia e Shërbimeve Dixhitale dhe të të Dhënave të Popullsisë do të dërgojë një kartë njoftimi që të informon për të drejtën e votës deri më maksimumi **20 maj 2021**. Karta i dërgohet çdo personi që ka të drejtën e votës dhe që i dihet adresa. Karta e njoftimit do të dërgohet vetëm në formën dixhitale nëse je regjistruar për shërbimin e Mesazheve nga Suomi.fi, i cili sigurohet nga Agjencia e Shërbimeve Dixhitale dhe të të Dhënave të Popullsisë (për më shumë informacione, vizito [www.suomi.fi/messages](http://www.suomi.fi/messages)).

Njoftimi për të drejtën e votës përfshin udhëzime për procesin e votimit, një listë të qendrave të votimit paraprak në afërsi të vendbanimit tënd dhe informacione për të drejtën tënde të votës. Nuk është e nevojshme të sjellësh njoftimin për të drejtën tënde të votës në qendrën e votimit, por do të duhet të vërtetosh identitetin tënd para se të votosh.

## **Përshtatshmëria - kush mund të jetë kandidat?**

Mund të kandidosh në komunën tënde të rezidencës nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

- je rezident në komunën ku dëshiron të kandidosh
- ke të drejtën për të votuar në një komunë të Finlandës
- nuk je deklaruar ligjërisht i paaftë

Ki parasysh se zyrtarë shtetërorë të caktuar, zyrtarët e lartë të komunave dhe punonjësit e renditur në Ligjin për qeverisjen vendore nuk mund të kandidojnë në zgjedhjet lokale.

## **Caktimi i kandidatëve në zgjedhjet lokale**

Në zgjedhjet lokale, kandidatët mund të caktohen nga

- partitë e regjistruara
- shoqatat elektorale të themeluara nga persona me të drejtë vote.

Çdo parti mund të vendosë për kandidatët e saj në përputhje me rregullat dhe rregulloret e saj. Nëse dëshiron të marrësh pjesë si kandidat i një partie, duhet ta diskutosh këtë me partinë tënde të preferuar.

Për themelimin e një shoqate elektorale duhen të paktën dhjetë persona me të drejtë vote që banojnë në komunën në fjalë. Megjithatë, në komunat me popullsi më të vogël, duhen vetëm tre ose pesë banorë.

Dy ose më shumë parti kanë të drejtën të krijojnë një aleancë elektorale. Dy ose më shumë shoqata elektorale kanë të drejtën të krijojnë një listë të përbashkët.

Numri i kandidatëve të caktuar nga një parti, aleancë elektorale ose listë e përbashkët në një komunë mund të jetë maksimumi 1,5 herë më i lartë se numri total i këshilltarëve që do të zgjidhen. Në varësi të popullsisë së komunës, në këshillin e komunës zgjidhen minimumi 13-79 këshilltarë, por një komunë mund të vendosë të zgjedhë edhe një numër më të madh këshilltarësh.

Çdo kandidati do t'i caktohet një numër. Do të hartohet një listë kryesore e kandidatëve, ku të gjithë kandidatët shfaqen në rend numerik, duke filluar nga numri 2. Në listën kryesore, kandidatët grupohen sipas partisë ose listës së përbashkët. Lista kryesore do të përfshijë informacionet e mëposhtme për çdo kandidat: emrin, numrin e kandidatit dhe profesionin e tij. Përveç kësaj, lista kryesore do të tregojë se

- cilat parti kanë krijuar një aleancë elektorale
- cilat shoqata elektorale kanë krijuar një listë të përbashkët
- cilat parti nuk bëjnë pjesë në një aleancë elektorale
- cilët kandidatë konkurrojnë jashtë listës së përbashkët.

Lista kryesore e kandidatëve do të hartohet në të gjitha komunat më 18 mars 2021. Lista kryesore e komunës është e disponueshme p.sh. në dhomat e fshehta dhe në faqet e zgjedhjeve të Ministrisë së Drejtësisë ([www.vaalit.fi](http://www.vaalit.fi)). Nëse planifikon të votosh paraprakisht në një komunë tjetër të ndryshme nga komuna jote e rezidencës, mund të kërkes nga zyrtarët e zgjedhjeve listat kryesore të kandidatëve të komunës sate.

## Datat e votimit

Mund të votosh në ditën e zgjedhjeve të dielën më 18 prill 2021 ose para ditës së zgjedhjeve gjatë periudhës së votimit paraprak. Mund të votosh vetëm një herë. Votimi dy herë është një shkelje e dënueshme sipas Kodit penal.

### Votimi paraprak:

Votimi paraprak në Finlandë fillon ditën **e mërkurë, më 26 maj 2021** dhe përfundon ditën **e martë, më 8 qershor 2021**.

Votimi paraprak jashtë shtetit fillon ditën **e mërkurë, më 2 qershor 2021** dhe përfundon ditën **e shtunë, më 5 qershor 2021**.

Në disa qendra të votimit paraprak, periudha e votimit është më e shkurtër.

Mund të votosh paraprakisht në çdo qendër votimi në Finlandë ose jashtë shtetit. Sa më poshtë mund të funksionojë si qendra të votimit paraprak:

- qendrat e votimit paraprak në Finlandë që janë përcaktuar nga komunat, p.sh. zyrat lokale
- disa misione finlandeze jashtë shtetit
- institucionet si spitalet, qendrat e kujdesit social dhe institucionet e korrektimit  
Në këto institucione mund të votojnë vetëm ata që janë pacientë ose që vuajnë dënimin aty.
- Anijet finlandeze që janë jashtë shtetit gjatë periudhës së votimit paraprak. Vetëm personeli i anijes mund të votojë kur anija është në lundrim, pasagjerët nuk mund të votojnë në anije.

### **Votimi në ditën e zgjedhjeve:**

Në ditën e zgjedhjeve, votimi do të zhvillohet ditën **e diel, më 13 qershor 2021, nga ora 9 deri në orën 20.**

Në ditën e zgjedhjeve, mund të votosh vetëm në qendrën e votimit të shënuar në njoftimin për të drejtën e votës që të është dërguar.

### **Votimi nga shtëpia:**

Nëse aftësia jote për të lëvizur ose vepruar është e kufizuar në atë masë sa nuk mund të shkosh në një qendër votimi pa vështirësi të arsyeshme, mund të votosh nga shtëpia gjatë periudhës së votimit paraprak.

Duhet të regjistrohesh për të votuar nga shtëpia deri ditën **e martë, më 1 qershor 2021** para orës 16. Për t'u regjistruar, kontakto me bordin qendror të zgjedhjeve lokale për komunën tënde të rezidencës. Detajet e kontaktit të bordit mund të gjenden në njoftimin për të drejtën e votës. Në kushte të caktuara, një kujdestar i familjes që jeton në të njëjtën shtëpi mund të votojë në të njëjtën kohë.

### **Votimi me postë:**

Nëse do të jesh jashtë shtetit gjatë të gjithë periudhës së votimit paraprak dhe në ditën e zgjedhjeve, mund të votosh gjithashtu me postë nga jashtë shtetit.

Për të votuar me postë, porosit materialet e nevojshme të votimit nga shërbimi në internet i Ministrisë së Drejtësisë për në adresën tënde jashtë shtetit. Porositë mund të kryhen jo më herët se tre muaj para ditës së zgjedhjeve. Si një person me të drejtën e votës, ti je përgjegjës për të porositur dokumentet e nevojshme të votimit në kohën e duhur që të mund ta dërgosh fletëvotimin tënd në zarfin përkatës te bordi qendror i zgjedhjeve lokale për komunën tënde brenda kohës së specifikuar në ligjin zgjedhor.

## Si të votosh

Për të votuar gjatë periudhës së votimit paraprak ose në ditën e zgjedhjeve, shko te qendra jote lokale e votimit. Mund të votosh vetëm për një nga kandidatët e renditur në listën kryesore të kandidatëve në komunën tënde.

**1) Vërteto identitetin tënd para zyrtarit të zgjedhjeve** duke treguar pasaportën, kartën e identitetit, lejen e drejtimit të automjetit ose një dokument tjetër të ngjashëm. Zyrtari i zgjedhjeve do të të japë një fletëvotimi.

**2) Shko te dhoma e fshehtë.** Vetëm një person mund të hyjë në një dhomë të fshehtë në të njëjtën kohë.

**3) Shëno numrin e kandidatit për të cilin po voton në fletën e votimit.** Mund të votosh vetëm për një kandidat. Shkruaj numrin e kandidatit në rrethin në fletën e votimit. Mos shkruaj apo vizato diçka tjetër në fletën e votimit. Palose fletën e votimit në mënyrë që numrin që ke shkruar të qëndrojë brenda dhe të mos jetë i dukshëm për asnjë tjetër.

**4) Çoje fletën e palosur të votimit te zyrtari i zgjedhjeve.** Ai do ta vulosë fletën e votimit.

5a) Nëse voton në ditën e zgjedhjeve, **hidhe fletën e vulosur të votimit në kutinë e votimit.**

5b) Nëse po voton paraprakisht, **zyrtari i zgjedhjeve do të të japë një zarf zgjedhor ku do ta mbyllësh fletën tënde të votimit të vulosur.**

Nëse ke vështirësi të konsiderueshme për të shkruar numrin e një kandidati në fletën e votimit, mund të kërkosh nga një ndihmës i zgjedhur nga ty për votimin ose nga një zyrtar i zgjedhjeve që të të ndihmojë të hedhësh votën tënde. Ndhmësi yt nuk mund të jetë një kandidat ose një i afërm i një kandidati. Ndhmësi yt do të jetë i detyruar të ruajë sekretin e fletës sate të votimit d.m.th. të mbajë sekret çdo informacion në lidhje me votën tënde.

## Informacione shtesë

- Për më shumë informacione për zgjedhjet, kontakto me bordin qendror të zgjedhjeve lokale për komunën tënde.  
Çdo pyetje në lidhje me të drejtat personale për votimin mund të dërgohet tek Agjencia e Shërbimeve Dixhitale dhe të të Dhënave të Popullsisë.  
Detajet e kontaktit për të dyja këto janë të disponueshme në njoftimin për të drejtën e votës.
- Adresat dhe oraret e qendrave të votimit paraprak, udhëzimet për të porositur votën me postë, informacionet për kandidatët dhe informacione të tjera zgjedhore mund të gjenden në faqen e internetit të zgjedhjeve të Ministrisë së Drejtësisë në **[www.vaalit.fi](http://www.vaalit.fi)**.
- Informacionet për kandidatët që konkurrojnë në zgjedhjet lokale mund të gjenden në faqet e zgjedhjeve të Ministrisë së Drejtësisë pas datës 14 maj 2021.  
Informacionet për qendrat e votimit paraprak do të jenë të disponueshme pas datës 12 prill 2021.
- Ky komunikim, i publikuar fillimisht në dhjetor 2020, është përditësuar për të pasqyruar ndryshimet si rezultat i ligjit për shtyrjen e zgjedhjeve lokale 2021 (256/2021).

Agjencia e Shërbimeve Dixhitale dhe të të Dhënave të Popullsisë, 29 mars 2021